



RAPORT PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË DRENASIT 2016

Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracy në Veprim” (DnV) ka angazhuar 99 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit, të mbajtura më 4 dhjetor 2016. Për raundin e dytë të zgjedhjeve janë akredituar edhe 34 vëzhgues të tjerë. Vëzhguesit janë vendosur të gjithë 72 vendvotimet në 28 qendra të votimit, për të vëzhguar përgatitjet për hapjen e vendvotimeve, të gjithë procesin e votimit, mbylljen e vendvotimeve si dhe në fund numërimin e rezultateve. Fushata zgjedhore e kandidatëve është vëzhguar nga 2 vëzhgues afatgjatë të zgjedhjeve, përfshirë tubimet e kandidatëve, takimet me grupet e interesit dhe vizitat në shtëpi private.

PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE DHE PËRFUNDIMET

- DnV konsideron se përkundër parregullsive të cilat janë identifikuar, procesi ka qenë i qetë dhe nuk është prekur nga shkelje të rënda dhe të dhunshme gjatë votimit dhe numërimit të votave në ditën e zgjedhjeve. Parregullsitë më të shpeshta kanë qenë votimi familjar, fotografimi i votës, asistimi i votuesve më shumë se një herë, mos gjetja e emrave në listën e votuesve, prania e personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit. Këto nuk e kanë minuar besimin e publikut në procesin zgjedhor.
- Periudha parazgjedhore ka qenë e intensifikuar me aktivitete të kandidatëve, në të cilat janë gjetur parregullsi të ndryshme si: përdorimin e fëmijëve në fushatë zgjedhore, në raste të caktuara edhe në mënyrë të organizuar; shfrytëzimin e veturave zyrtare për qëllime partiake dhe prani të shërbyesve civil; vendosjen e materialeve propaganduese të kandidatëve në shenja të komunikacionit, shtylla elektrike, hapësira publike të cilat nuk janë të destinuara për këtë qëllim; Në disa raste gjuha e përdorur ka qenë ofenduese për kundër kandidatët.
- DnV pranon rolin pozitiv të vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të votuesve dhe vlerësimin e pavarur të procesit zgjedhor.
- DnV vlerëson aktivitetin dhe përpjekjet e shumë komisionerëve që kanë kryer detyrat e tyre me profesionalizëm duke pas parasysh afatet e shkurtuara për përgatitje.

Historiku i zgjedhjeve në Drenas

Zgjedhjet e fundit për Kryetar të Komunës së Drenas janë mbajtur në afatin e rregullt kushtetuese me 3 nëntor 2013. Nga 50,079 votues sa ishin të regjistruar në listën e votuesve në votime kanë marrë pjesë 24,171 votues ose 48,3%. Në raundin e parë kryetar ishte zgjedhur kandidati i PDK-së Nexhat Demaku. Ky ishte mandati i tretë për të, mandat nga i cili dha dorëheqje më 25 tetor 2016, një ditë pasi Gjykata e Apelit vërtetoi aktgjykimin në rastin e njohur si “Drenica 2”, në të cilin rast z. Demaku ishte dënuar me 3 vjet burg për vepra penale që ndërlidhen me kohën e luftës.

Ligjit për Qeverisjen Lokale parasheh përfundimin e mandati të kryetarit të komunës në rast se me një vendim përfundimtar të gjykatës kryetari privohet nga cilësia juridike. Ndërsa neni 11.2 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale parasheh që kryetari i komunës, të cilit i ka përfunduar mandati, zëvendësohet përmes mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në atë komunë.

Me vendim të Presidenti Thaçi, data e zgjedhjeve është caktuar për 4 dhjetor.

Korniza ligjore

Sipas kornizës ligjore në Kosovë, kryetari i komunës zgjidhet në bazë të sistemit drejtpërdrejt nga votuesit të cilët janë të regjistruar për të votuar në komunën ku mbahen zgjedhjet për kryetar të komunës.

Kandidati zgjedhet kryetar i komunës nëse ai apo ajo fiton më shumë se 50%, plus një (1) votë. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk arrin të marrë 50% plus një (1) votë atëherë organizohet raundi i dytë zgjedhor (balotazh) mes dy kandidatëve që kanë fituar më së shumti vota. Raundi i dytë i zgjedhjeve zhvillohet katër javë pas raundit të parë të zgjedhjeve.

Zgjedhjet e parakohshme lokale për asamble komunale apo për kryetarë komune shpallen nga Presidenti i Kosovës dhe nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë, apo jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas pushimit të mandatit të kryetarit.

Kryetar me mandat të shkurtuar

Neni 11.2 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale parasheh që në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Komunës, mandati i pasardhësit të tij është i njëjtë me mandatin e tij. Kryetari i cili do të zgjedhet nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të Drenasit, do të ketë mandat më të shkurtër sesa një vit kalendarik.

Kjo dispozitë ligjore është pozitive në kuptimin e ruajtjes së ciklit normal zgjedhor për të mos lejuar që zgjedhjet komunale të zhvillohen në data të ndryshme, të ketë një datë unike për zgjedhjet lokale në të gjithë territorin e vendit.

Mirëpo në anën tjetër, gara për mandat të shkurtuar, bëhet e pa leverdishme për subjektet politike duke e ditur se në më pak se një vit do të ketë zgjedhje të reja dhe ato nuk mund të ofrojnë programe qeverisëse për atë komunë pasi që periudha është e shkurtër.

Certifikimi i kandidatëve

Subjektet politike të cilat janë certifikuar nga KQZ për të garuar me kandidatët e tyre në zgjedhje janë: Partia Demokratike e Kosovës me kandidat Ramiz Lladrovci, Lidhja Demokratike e Kosovës me Bedri Nika, Nisma për Kosovën me Isa Xhemajlaj, Aleanca Kosova e Re me Elmi Thaçi, Fjala me Vehbi Berisha, Kandidatët e Pavarur Xhavit Drenori, Naim Bazaj dhe Rrahim Elshani.

Pas certifikimit, KQZ-ja ka pranuar një kërkesë me shkrim nga kandidati i pavarur z. Naim Bazaj për tërheqje nga gara. Sipas kërkesës së kandidatit, janë plotësuar kushtet e parapara me Ligj që KQZ-ja të bëjë decertifikimin e tij.

KQZ ka bërë fillimisht tërheqjen e kandidatit Naim Bazaj nga fletëvotimi. Pas këtij vendimi, subjekti politik Nisma ka parashtruar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me pretendimin se tërheqja është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Vendimi përfundimtar i PZAP-së ka aprovuar kërkesën e subjektit Nisma duke anuluar vendimin e KQZ-së për tërheqje nga fletëvotimi të kandidatit Bazaj. Përkundër tërheqjes nga gara, z. Naim Bazaj do të paraqitet në fletëvotim.

Listat e votuesve, numri i votuesve dhe qendrat e votimit

KQZ ka bërë edhe aprovimin e listës së votuesve për Drenas, ku personat që do të kenë të drejtë vote janë 52,569, prej të cilëve rreth 4% votues për herë të parë. 1,600 persona janë larguar nga lista e votuesve me qëllim të pastrimit të tyre nga personat e vdekur, ndërsa 1,224 votues janë shpërngulur në komunat tjera. Në këtë zgjedhje, me vendim të Gjykatës 7 persona kanë humbur zotësinë juridike për të marrë pjesë në zgjedhje.

KQZ ka aprovuar edhe numrin e qendrave të votimit prej 28, katër nga të cilat janë qendra të reja që nuk qenë në zgjedhjet e kaluara (Likoshan, Verboc, Gllobar dhe Shtuticë). Gjithsej në këto qendra të votimit do të jenë 72 vendvotime.

Fushata zgjedhore

Pas shpalljes së zgjedhjeve bazuar në kompetencat dhe planin operacional për përgatitjen e zgjedhjeve KQZ-ja ka marrë vendim që fushata zgjedhore të zgjasë vetëm pesë (5) ditë.

Me dispozitat ligjore për zgjedhjet e jashtëzakonshme KQZ-së i lejohet t'i rishikoj afatet kohore për fushatë, mirëpo nuk është e përcaktuar në mënyrë specifike kohëzgjatja e fushatës zgjedhore.

Aktivitetet zgjedhore fillojnë para fushatës zgjedhore - Megjithatë, fushata zgjedhore prej pesë (5) ditësh për kandidatët e pavarur dhe subjektet politike është cilësuar si shumë e shkurtër. Në anën tjetër, mungesa e specifikimit të sanksioneve për rastet kur fillon fushata para afatit të përcaktuar, ka bërë që partitë politike dhe kandidatët e pavarur të fillojnë fushatën zgjedhore shumë më herët se afati zyrtar.

Edhe pse Drenasi është një komunë relativisht e vogël dhe se kohëzgjatja e mandatit të kryetarit të ri do të jetë shumë e shkurtër, disa nga partitë politike dhe liderët e këtyre subjekteve, si ai i PDK-së, Nismës, AKR-së i kanë dhënë vëmendje të konsiderueshme këtij procesi duke e parë edhe si tregues dhe të fuqisë së tyre politike dhe në nivel vendi.

Fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore - Që nga hapja e fushatës zgjedhore, DnV ka përcjellë tubimet e kandidatëve, takimet me grupet e interesit, vizitat në shtëpi private. Janë takuar të gjithë kandidatët që janë në garë për t'u informuar nga ta lidhur me ecurinë e fushatës, janë zhvilluar takime me zyrtarë të KQZ-së dhe KKZ-së për të parë përgatitjet lidhur me organizimin e zgjedhjeve.

Në përgjithësi konstatohet se fushata zgjedhore ka qenë e qetë dhe nuk janë shënuar incidente serioze të cilat do të mund të dëmtonin mbarëvajtjen e saj, ndonëse ka pasur parregullsi të cilat janë identifikuar nga ekipet tona në teren, e që përfshijnë:

- Përdorimin e fëmijëve në fushatë zgjedhore, madje në raste të caktuara edhe në mënyrë të organizuar;
- Shfrytëzimin e veturave zyrtare për qëllime partiake dhe prani të shërbyesve civil;

- Vendosjen e materialeve propaganduese të kandidatëve në shenja të komunikacionit, shtylla elektrike, hapësira publike të cilat nuk janë të destinuara për këtë qëllim;
- Në raste të caktuara gjuha e përdorur ka qenë ofenduese për kundër kandidatët;

Për shkelje të këtyre rregullave të fushatës zgjedhore, DnV ka dorëzuar dy ankesat e para në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP) ndaj PDK-së dhe LDK-së. Që të dy ankesat janë pranuar si të bazuara dhe janë gjobitur me nga 1,200 euro për shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore.

Vlerësojmë si pozitive angazhimin e KQZ-së për organizmin e zgjedhjeve, me përjashtim të rastit të largimi nga fletëvotimi të dy kandidatëve të certifikuar, vendim i cili u anulua nga PZAP. Policia ka qenë e pranishme në tubimet publike dhe ka kryer me profesionalizëm punën e saj. Është e mirëseardhur përfshirja e Prokurorëve në ditën e zgjedhjeve, përfshirje kjo e treguar e efektshme në zgjedhjet e kaluara. Nga kandidatët kërkojmë që të ju përmbahen rregullave të garës, kurse nga qytetarët që t'i përgjigjen ftesës për të votuar.

Vëzhguesit e zgjedhjeve

Me rekomandim të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, KQZ-ja ka akredituar gjithsej 853 vëzhgues, përfaqësues të subjekteve të certifikuara politike, kandidatëve të pavarur, organizatave joqeveritare vendore dhe atyre ndërkombëtare dhe mediave për vëzhgim të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Drenasit. Nga subjektet e certifikuara politike dhe një kandidatë i pavarur, janë akredituar gjithsej 524 vëzhgues. Nga organizatat ndërkombëtare të akredituar ka qenë 49 vëzhgues. Nga organizatat joqeveritare vendore 207 vëzhgues. Ndërsa nga mediat vendore 73 vëzhgues.

Dita e zgjedhjeve

DnV në kuadër të vëzhgimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Drenas, në ditën e zgjedhjeve përkundër parregullsisve të cilat janë identifikuar, procesi ka qenë i qetë dhe nuk është prekur nga shkelje të rënda dhe të dhunshme gjatë votimit dhe numërimit të votave në ditën e zgjedhjeve.

Janë evidentuar vonesat në hapje të vendvotimeve dhe disa parregullsi të tjera teknike. Nga të dhënat e marra nga vëzhguesit në teren është raportuar për vonesa në hapjen e 10 % të vendvotimeve të cilat në disa raste kanë shkuar deri në 50 minuta.

Parregullsia më e shpeshtë që është evidentuar në shumicën e vendvotimeve ka qenë votimi familjar, kur më shumë se një person voton prapa kabinës së votimit. Kjo dukuri është identifikuar në 68 raste. Janë raportuar së paku 86 raste me vështirësi të votuesve për t'a gjetur emrin e tyre në listën e votuesve. Fotografimi i votës, ndonëse i ndaluar me ligj, raste të tilla janë vërejtur në së paku gjashtë (6) vendvotime/raste. Po ashtu është vërejtur edhe prania e personave të paautorizuar në vendvotime, ku janë evidentuar të paktën 6 raste.

Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhje ka qenë 21,604 prej të cilëve 598 të tjerë me kusht. Shprehur në përqindje në zgjedhje kanë marrë pjesë 41.21% e votuesve të regjistruar në listën e votuesve.

Trendet e daljes sipas periudhave kohore:

- Dalja e deri në orën 12:00 ka qenë 6,956 votues (përfshirë ata me kusht) apo shprehur në përqindje 13.23%.

- Dalja deri në orën 16:00 ka qenë 16,889 votues apo shprehur në përqindje 32%. Trendi i daljes nga ora 12:00 është rritur për 19%
- Trendi i daljes së votuesve deri në përmbyllje nga ora 16:00 është rritur për 9%.

Mbyllja e të gjitha vendvotimeve është bërë në kohë dhe nuk është regjistruar ndonjë parregullsi. Mbarëvajtja e procesit të numërimit ka qenë e rregullt, me përjashtim të dy vendvotimeve ku disa komisioner kanë bojkotuar procesin si pasojë e lodhjes. Pas intervenimit të KQZ-së numërimi edhe në këto vendvotime është përfunduar.

Shqyrtimi i ankesave

Në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) janë dorëzuar 5 ankesa për parregullsi për ditën e votimit. Nga ankesat e pranuar, vetëm njëra prej tyre është pranuar dhe ka të bëjë me një komisioner të vendvotimit 0316e/02D i cili nuk kishte evidentuar personat të cilët kishin nevojë për ndihmë për të votuar. Ndaj këtij komisioneri është shqiptuar masa e ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje për tre vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Caktimi i datës për raundin e dytë dhe Certifikimi i rezultateve

Vendimi i KQZ-së për caktimin e datës për raundin e dytë është marrë në ora 15:30 pa përfunduar afati prej 24 orësh nga data e mbajtjes së zgjedhjeve për të dorëzuar ankesat, pa u numëruar fletëvotimet me kusht, dhe për më tepër pa u bërë certifikimi i rezultateve zgjedhore. KQZ nuk ka marrë parasysh që PZAP mund të urdhëroj KQZ-në të rinumëroj apo të përsërisë votimin në ndonjë Qendër të votimit në rast se konstatohen parregullsi.

Për më tepër, vendimi për caktimin e datës për raundin e dytë të zgjedhjeve është bërë në kundërshtim me nenin 9.6 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale që përcakton se Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet ditën e diele katër (4) javë pas raundit të parë, duke shkurtuar kështu në mënyrë të kundërligjshme afatin për raundin e dytë. Përkundër që Neni 4.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale parasheh mundësinë e ndryshimit të afateve kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ne pretendojmë që ky Nen ka të bëjë vetëm me qeverisjen e zgjedhjeve dhe jo me caktimin e afateve të cilat janë qartë të përcaktuara në nenin 9.6 të këtij ligji.

Dy ditë pas datës së mbajtjes së zgjedhjeve, KQZ ka bërë edhe certifikimin e rezultateve. Asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë numrin e nevojshëm të votave prej 50+1% për t'u zgjedhur në raundin e parë. Raundi i dytë i zgjedhjeve është caktuar për datë 18 dhjetor 2016, ndërmjet dy kandidatëve më të votuar Ramiz Lladrovci (PDK) me 45.34% të votave dhe Isa Xhemajlaj (NISMA) me 26.19%.

Raundi i dytë i votimit

Fushata për raundin e dytë zyrtarisht ka filluar me 12 dhjetor dhe ka zgjatur deri më 16 dhjetor. Në përgjithësi fushata cilësohet si e qetë dhe nuk janë regjistruar incidente serioze. Prania e policisë ka qenë në të gjitha tubimet publike dhe sjellja e tyre ka qenë konform rregullave ligjore. Prania e fëmijëve nën moshën 18 vjeçare është evidentuar në tubimet e të dy kandidatëve, po ashtu edhe e shërbyesve publik. Pjesëmarrja e grave në fushatë zgjedhore ka qenë shumë e ulët dhe sillet në shifra rreth 5% të të gjithë të pranishmëve.

Në ditën e votimit 70 nga 72 vendvotime sa kanë qenë gjithsej janë hapur me kohë dhe nuk janë evidentuar mungesa të materialeve të votimit. Vonesat në 2 vendvotimet kanë qenë në kohëzgjatje prej 10 minuta dhe kanë ardhur si pasojë e vonesave të komisionarëve.

Në vendvotime kanë qenë të angazhuar 346 komisionerë, prej tyre 279 burra (80.64%) dhe 67 gra (19.36%). Numri i vogël i komisionerëve gra është në kundërshtim me Deklaratën për rritjen e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore të nënshkruar nga përfaqësuesit e subjekteve politike të cilat janë zotuar për pjesëmarrje të paktën të 40% të grave në trupat zgjedhore.

Qasja e personave me aftësi të kufizuar ka munguar në 3 qendra të votimit. Në Kishnarekë votimi është zhvilluar në katin e dytë, gjë që ka pamunësuar votimin e personave me aftësi të kufizuar. Dy qendrat tjera me mungesë të qasjes apo bllokim të pjerrinës kanë qenë në qendrat e votimit në Krajkov dhe Arllat.

Vendosja e vëzhguesve në 4 vendvotime nuk është bërë sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të KQZ-së e cilat parasheh që vëzhguesit të ulën prapa komisionerëve të këshillave të vendotimeve, me qëllim që të kenë pamje më të qartë për të evidentuar parregullsitë eventuale.

Parregullsitë më të shpeshta gjatë ditës së votimit kanë qenë të ngjashme me ato të raundi të parë dhe përfshijnë: Fotografimin e fletëvotimit (12 raste të evidentuara), votimin familjar apo në grup (64 raste), personi i njëjtë ka asistuar më shumë se një herë votuesit që kanë pasur vështirësi për të votuar (5 raste), në njërin prej tyre ka qenë i përfshirë një nga anëtarët e KVV-së. Ndërsa vështirësitë për të gjetur emrin në listën e votuesve kanë pasur 144 persona.

Prej parregullsive më serioze ka qenë lejimi i votuesve për të votuar në rastet ku u janë gjetur njolla të sprejit në duar, por të cilët nuk e kanë qenë të nënshkruar që kanë votuar më parë në listat e votuesve. Kjo dukuri është vërejtur në 5 qendra të votimit (Nekoc, Tërstenik, Poklek, Gllanasellë dhe Glllogoc).

Të gjitha vendvotimet janë mbyllur me kohë në ora 19:00 dhe nuk janë regjistruar incidente. Dalja në zgjedhje në raundin e dytë ishte 44.32% apo 4.77% më e lartë se në raundin e parë. Nga rezultatet preliminare kandidati i PDK-së Ramiz Lladrovci është zgjedhur për kryetarë të komunës me 63% të votave, ndërsa kandidati i NISMA-së ka marrë 37% të votave.

Në PZAP janë dorëzuar 5 ankesa lidhur me procesin në raundin e dytë. Nga to, 3 ankesa kanë të bëjnë me thyerjen e heshtjes zgjedhore, kurse 2 të tjera për procesin e votimit (njëra për votim në emër të dikujt tjetër, kurse tjetra për parregullsi gjatë votimit). Të dy këto ankesa janë dorëzuar nga subjekti politik NISMA.